

URDHËR
Nr. 123, datë 28.7.2021

PËR DELEGIMIN E KOMPETENCËS PËR NËNSHKRIMIN E DOKUMENTEVE
ADMINISTRATIVE, QË DALIN NGA ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË
DREJTËSISË

(ndryshuar me urdhrin nr. 90, datë 3.8.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 147/d të Kushtetutës dhe në zbatim të nenit 204, pika 1, shkronja “c” të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, të ndryshuar, dhe të neneve 28–29, të ligjit nr. 44/20151, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”,

URDHËROJ:

1. *Delegimin e kompetencës së nënshkrimit të dokumenteve administrative që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, sipas fushës së përgjegjësisë që mbulon Drejtoria e Hartimit të Akteve dhe Shërbimeve Juridike, Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse dhe Drejtoria e Analizës dhe Standardeve.*

2. Ngarkohet znj. Dëshira Pasko, Sekretar i Përgjithshëm, për nënshkrimin e dokumenteve që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, që lidhen me:

- a) Kërkesat për informacion të publikut;
- b) Kërkesat për informacion nga institucionet e sistemit të drejtësisë;
- c) Informacionet në kuadër të përgatitjes së raportimeve dhe të dhënave statistikore për veprimtarinë e Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- d) Kërkesat të cilat nuk janë kompetencë e njësisë së inspektorëve;
- e) Korrespondenca që lidhet me çështje dhe shërbime juridike;
- f) Aktet në zbatim të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe Kodi i Punës, për personelin administrativ të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.

g) *Nënshkrimin e autorizimeve për përfaqësimin e çështjeve në gjykatë dhe në të gjitha shkallët e gjykimit, në mungesë të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.*

3. Me hyrjen në fuqi të këtij urdhri ngarkohen njësitë që administrojnë kërkesat e ardhura apo që u drejtohen subjekteve të përcaktuara në pikën 2 të këtij urdhri, të hartojnë ekzemplarët e shkresave dalëse, sipas përcaktimeve të këtij urdhri dhe në përputhje me parashikimet e bëra në urdhrin nr. 8, datë 21.1.2021, të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për njësimin e dokumentit administrativ”.

4. Urdhri nr. 4, datë 8.1.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë “Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e dokumenteve administrative, që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, si dhe urdhri nr. 117, datë 6.7.2021, i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, “Për delegimin e kompetencës për nënshkrimin e dokumenteve administrative, që dalin nga Zyra e Inspektorit të Lartë Drejtësisë”, shfuqizohen me miratimin e këtij urdhri.

5. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për zbatimin dhe njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË
Artur Metani